

SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita: Ekonomist për Stabilitet Financiar/Zyrtar (një pozitë)
Departamenti/divizioni: Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Stabilitetit Financiar
Niveli i gradës: 6
I raporton: Drejtorit
Numri i vartësve: -

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi:

- Implementon programin afatshkurtër dhe afatmesëm të punës në departament/njësinë për stabilitet financiar;
- Merr pjesë në përgatitjen e analizave të sektorit financiar në funksion të arritjes së objektivave përkatëse dhe realizimit të detyrave përkatëse të BQK-së;
- Kontribuon në vlerësimin e rrezikut sistematik, përmes analizimit dhe avancimit të vazhdueshëm të instrumenteve dhe modeleve për vlerësimin e këtij rreziku;
- Analizon dinamikat e tregjeve dhe institucioneve financiare, me qëllim të identifikimit të rreziqeve që përbëjnë kërcënime për stabilitetin e sistemit financiar;
- Kontribuon në definimin e kërkesave për të dhënat e nevojitura në procesin e hulumtimit duke përfshirë mbledhjen, përpilimin dhe organizimin e të dhënave statistikore relevante për procesin e hulumtimeve;
- Rekomandon dhe kontribuon në çështje të ndryshme me relevancë për fushën e stabilitetit financiar dhe proceset e punës në departament;
- Mbështetë bashkëpunimin e nevojshëm me të gjitha palët relevante përkitazi me çështjet e stabilitetit financiar;
- Përbush detyra tjera në bazë të kërkesës së mbikëqyrësit.

Kualifikimet e kërkuara:

- Diplomë bachelor në ekonomi, banka dhe financa, matematikë financiare apo fushë tjetër kuantitative me përmbytje ekonomike dhe financiare. Përparësi studimet e përfunduara në nivel master;
- Njohuri dhe shkathtësi në fushën e ekonometrisë dhe modelimit;
- Të ketë minimum përvojë pune 1 vjeçare në fushën ekonomike dhe financiare;
- Njohuri analitike, të nevojshme për analiza makroekonomike dhe financiare;
- Kërkohen aftësi për vlerësime dhe punë të pavarur nga mbikëqyrësi;
- Aftësi shumë të mira komunikuese dhe aftësi për të punuar në mënyrë efektive në ekip;
- Njohja e mirë e programeve softverike si Stata, EViews dhe programe tjera relevante.

Njohja e gjuhëve të huaja:

- Preferohet të ketë njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze – verbale dhe në të shkruar.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente e mbështetur me dëshmi nga Trust;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **06 qershor 2022**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**